



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	26.12.2025	
Nr. llogar. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-463/06-0082566/25		
PODUJEVO - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 4 dhe 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, nenit 97 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me Hartën Zonale të Komunës së Podujevës (HZK) për periudhën 2022-2030, e miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. Prot. 01-020/02-0030654/22, datë 29 prill 2022, në kërkesë Nr. Prot. 02-464/01-0022232/24 datë 05 prill 2024 të Drejtorisë së Arsimit merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

Neni 1

Miratohet shpronësimi i objekteve në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim detaj të paluajtshmërive, si në shtojcë të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik, realizimin e projektit *"Ndërtimi i Çerdhes"*

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrale dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Arsimit që brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi të njëjtin t'ua dërgojë pronarëve ose zotëruesve të interesit në pjesë të pronave të paluajtshme të cilat preken me realizimin e projektit, dhe brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, i njëjti shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Neni 3

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave që brenda afatit prej dy (2) vite, të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të objekteve të shpronësuar, të përcaktuar në Aktin e vlerësimit nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave (shkresa nr. prot. 184-3/2025 dt 01.09.2025) i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi, secili pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose në të drejtat pronësore që janë objekt i këtij vendimi përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtpërdrejt në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, kanë të drejtë ankese në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr.03/L-205.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Arsimit.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij, vendim i cili paraqet bazë juridike për regjistrime në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Pronarëve ose zotëruesve të interesit
- QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-463/06-0081566/25
Podujevë, datë: 26.12.2025


Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Nr	Emri mbiemri i pronarit ose zotëruesit	Nr.i pjesës së ndërtesës	Lloji i shfrytëzimit	Zona Kadastrale	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja e pjesës së ngastrës për shpronësime m ²
1	Fatmir (Hysen) Stublla (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-7-0	Lokal	Podujevë	114	114
2	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-6-0	Lokal	Podujevë	344.1	344.1
3	Fatmir (Hysen) Stublla (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-5-0	Objekte te tjera	Podujevë	6	6
4	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-4-0	Lokal	Podujevë	134.86	134.86
5	-Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-3-0	Lokal	Podujevë	45.08	45.08
6	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-2-0	Lokal	Podujevë	241.8	241.8
7	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-1-0	Lokal	Podujevë	110.05	110.05

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Avni Fetahu



Drejtoreshë e DPKGJ-së

Saranda Stublla

